



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Ndryshimin e Afatit për Nxjerrjen e Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtësit të Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 9 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Vendimin mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës” (“Vendimi i Kundërshtuar”).²
2. Më 27 gusht 2021, Mbrojtja e Rexhep Selimit, Mbrojtja e Jakup Krasniqit dhe Mbrojtja e Hashim Thaçit (bashkërisht, “Mbrojtja”) kërkuan leje për apelin e Vendimit të Kundërshtuar (përkatësisht, “Kërkesa e Mbrojtjes së Selimit”, “Kërkesa e Mbrojtjes së Krasniqit” dhe “Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit”, dhe bashkërisht, “Kërkesat e Mbrojtjes”).³
3. Më 30 shtator 2021, Prokurori i Specializuar (“ZPS”) iu përgjigj Kërkesave të Mbrojtjes.⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 22 korrik 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00413/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00445, Mbrojtja e Rexhep Selimit, *Kërkesë e Mbrojtjes për Leje për Apelin të Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 27 gusht 2021, publike; F00446, Mbrojtja e Jakup Krasniqit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelin të “Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës”*, 27 gusht 2021, publike; F00447, Mbrojtja e Hashim Thaçit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelin të Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 27 gusht 2021, publike.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00500, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Jakup Krasniqit për Leje për Apelin të Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 30 shtator 2021, konfidenciale; F00502, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Rexhep Selimit për Leje për Apelin të Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 30 shtator 2021, publike; F00503, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Hashim Thaçit për Leje për Apelin të Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 30 shtator 2021, publike.

4. Më 8 tetor 2021, Mbrojtja e Jakup Krasniqit dhe Mbrojtja e Hashim Thaçit iu kundërpërgjigjën përgjigjeve të ZPS-së.⁵ Mbrojtja e Rexhep Selimit nuk parashtrroi kundërpërgjigje.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Rregulla 77(3) e Rregullores parashikon se, kur një palë kërkon leje për apelimin e vendimit të një Paneli, Paneli nxjerr vendim me arsyetim brenda shtatë (7) ditësh prej parashtrimit të fundit të palëve apo, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave.

6. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, Paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej Panelit.

III. DISKUTIM

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se afati i parashikuar në rregullën 77(3) të Rregullores llogaritet si më poshtë: (i) për Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit, nga përgjigjja e ZPS-së ndaj kërkesës në fjalë; dhe (ii) për Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit dhe për Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit, nga kundërpërgjigjet e dy ekipeve përkatëse të Mbrojtjes.

8. Duke marrë parasysh se të gjitha këto Kërkesa të Mbrojtjes lidhen me të njëjtin Vendim të Kundërshtuar dhe se pikat në lidhje me të cilat Mbrojtja kërkon leje për apelim përkojnë njëra me tjetrën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos të zgjasë

⁵ KSC-BC-2020-06, F00511, Mbrojtja e Jakup Krasniqit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Jakup Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 8 tetor 2021, konfidenciale; F00512, Mbrojtja e Hashim Thaçit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës për Leje për Apelim të "Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës"*, 8 tetor 2021, publike.

afatin për lëshimin e vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit deri më 18 tetor 2021.

IV. VENDIM

9. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **ZGJAT** afatin për lëshimin e vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit deri **të hënë, 18 tetor 2021**; dhe
- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre përkatëse F00500 dhe F00511 deri **të enjten, 14 tetor 2021**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E hënë, 11 tetor 2021

Në Hagë, Holandë